

1 E mërkurë, 13 dhjetor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Paraqitja e parë]

4 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 14.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita, të gjithëve ju që  
7 jeni në sallën e gjyqit dhe jashtë sallës së gjyqit.

8 Përpara se të fillojmë në vendimin për caktimin e datës  
9 për paraqitjen paraprake autorizova fotografen e Gjykatës të  
10 bëjë disa fotografi të të akzuarit. Kështu që do i lutesha  
11 fotografes të bëjë fotografi dhe ka një minutë e gjysmë për të  
12 bërë këtë.

13 Faleminderit, fotografe.

14 Sekretare e Gjykatës, ju lutem, paraqisni lëndën.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, kjo është  
16 çështja KSC-BC-2323-11, Prokurori i Specializuar kundër Haxhi  
17 Shalës.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

19 Përpara se t'u kërkoj personave që janë të pranishëm në  
20 sallën e gjyqit që të prezantohen, do ju lutesha të më dëgjoni  
21 se do ju kujtoj disa nga rregullat që duhen respektuar gjatë  
22 të gjithë kohës në mënyrë që procedurat të shkojnë siç duhet.

23 Ju lutem, ndizni mikrofonin përpara se të flisni dhe të  
24 fikni sapo të keni mbaruar fjalën.

25 Flisni ngadalë dhe qartë se kemi përkthimin nga dhe drejt

1 shqipes dhe serbishtes.

2 Prisni pesë sekonda përpara se të më përgjigjeni mua apo  
3 një pale apo pjesëmarrësi në mënyrë që t'u jepni mundësi  
4 përkthyesve të përfundojnë fjalinë.

5 Çka thuhet në këto seanca zbardhen në kohë reale dhe do  
6 të pasqyrohen në transkriptin që u vendoset në dispozicion  
7 palëve dhe publikut pas seancës.

8 Dua t'u kujtoj palëve që disa informacione në këtë  
9 çështje gjyqësore janë objekt masash të mbrojtjes edhe  
10 urdhrave për konfidencialitet. Informacioni konfidencial nuk  
11 do të jepet në seancë të hapur. Nëse ndonjë prej palëve apo  
12 pjesëmarrësve dëshiron të kalojmë në seancë private për të  
13 përendur informacion konfidencial ju lutem, jepni edhe arsyet.

14 Tani do ju lutesha palëve dhe pjesëmarrësve të  
15 prezantohen duke filluar me Zyrën e Prokurorit të  
16 Specializuar.

17 Znj. Prokurore.

18 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar  
19 Gjykatës. Për Prokurorin e Specializuar Tazneen Shahabuddin  
20 dhe pranë meje është Prokurori Joshua Hafetz.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

22 Tani shoh Mbrojtjen.

23 Z. VAN PUYENBROECK: [Përkthim] Mirëdita, jam Laurens Van  
24 Puyenbroeck jam Mbrojtësi i z. Shala.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

1 Vërej se klienti juaj, z. Shala është po ashtu i  
2 pranishëm në sallën e gjyqit.

3 I drejtohem tani Zyrës Administrative.

4 Z. NILSSON: [Përkthim] Mirëdita. Mirëdita kolegë, i  
5 nderuar Gjykatës, jam Jona Nilsson Zëvendës Administratori.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Edhe unë jam Nicolas  
7 Guillou, Gjykatësi i Procedurës Paraprake për këtë çështje  
8 gjyqësore.

9 I akuzuari shfaqet sot për herë të parë përpara Dhomave  
10 të Specializuara në bazë të aktakuzës të konfirmuar kundër  
11 tij.

12 Z. Shala, ju lutem çohuni në këmbë. A mund të na thoni  
13 emrin dhe mbiemri.

14 I AKUZUARI: Unë quhem Haxhi Shala.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Datëlindja dhe vendlindja  
16 juaj.

17 I AKUZUARI: 17 mars 1970.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Dhe vendlindja juaj?

19 I AKUZUARI: Banjë, Malishevë.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Çfarë nënshtetësie apo  
21 nënshtetësish keni?

22 I AKUZUARI: Kosovare dhe shqiptare.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Çfarë profesioni keni?

24 I AKUZUARI: Kështu jam ushtarak, përndryshe jam jurist.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, mund të uleni

1 z. Shala.

2 Tani të flasim për historikun procedural të kësaj çështje  
3 gjyqësore.

4 Më 4 dhjetor 2023 në cilësinë time si Gjykatës i  
5 Procedurës Paraprake konfirmova aktakuzën e dorëzuar nga  
6 Prokurori i Specializuar kundër z. Shala ku ngarkohej me  
7 akuzat e: Pika 1, tentativë për pengimin e personave zyrtarë  
8 në kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë;  
9 Pika 2, tentim për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e  
10 detyrave zyrtare përmes pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët  
11 të një grupi; Pika 3, frikësim gjatë procedurës penale.

12 Më 11 dhjetor 2023, Prokuroria e Specializuar arrestoi z.  
13 Shala në Kosovë në të cilin moment iu dorëzua edhe aktakuza e  
14 konfirmuar. Z. Shala u transferua në objektin e paraburgimit  
15 të Dhomave të Specializuara të Kosovës më 12 dhjetor 2023.

16 Z. Shala, përpara se të vijojmë më tej, duhet të  
17 sigurohem që ju mund t'i ndiqni procedurat në një gjuhë që ju  
18 e kuptoni dhe e flisni. Ju lutem, a mund të na konfirmoni se  
19 kuptoni edhe flisni shqip?

20 I AKUZUARI: Po, flas shqip.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] faleminderit, z. Shala. Me  
22 këtë jam i bindur se mund ta ndiqni procesin gjyqësor në  
23 gjuhën shqipe, gjuhë që ju e kuptoni dhe e flisni në përputhje  
24 me rregullën 92 të Rregullores të Procedurës dhe Provave.

25 Nëse gjatë seancave nuk merrni përkthim ju lutem, më

1 njoftoni menjëherë.

2 Tani më lejoni t'ju shpjegoj qëllimin specifik të  
3 paraqitjes paraprake për të akuzuarin dhe për ata që na  
4 ndjekin nga galeria publike si dhe për personat që na ndjekin  
5 përmes internetit.

6 Seanca e sotme nuk është gjykim. As nuk do të diskutohen  
7 as nuk do të paraqiten prova. Nuk do të diskutohet apo  
8 vendoset fajësia apo pafajësia e atë akuzuarit.

9 Qëllimi i paraqitjes paraprake rregullohet me nenin 39 të  
10 Ligjit dhe rregullën 92 të Rregullores. Në përputhje me këto  
11 dispozita si Gjykatës i Procedurës Paraprake, unë: Do të  
12 siguroj që t'i lexohen akuzat në Aktakuzën e Konfirmuar të  
13 akuzuarit në një gjuhë që ai e kupton dhe e flet; do të  
14 konfirmoj se i akuzuari e kupton aktakuzën; do të bindem se të  
15 drejtat e të akuzuarit, veçanërisht e drejta për avokat është  
16 respektuar; do të informoj të akuzuarin se brenda 30 ditësh  
17 nga seanca e sotme do të thirret për të pranuar fajësinë apo  
18 për t'u vetëdeklaruar i pafajshëm për secilën nga akuzat e  
19 paraqitura në aktakuzë. Nëse i akuzuari dëshiron mund të bëjë  
20 që sot dhe mund të vetëdeklarohet i fajshëm apo i pafajshëm.

21 Dhe së fundi, do të caktoj datat e tjera, sipas nevojës,  
22 në kryerjen e funksioneve të mia si Gjykatës i Procedurës  
23 Paraprake.

24 Unë uroj që palët t'i respektojnë këto aspekte të cilat  
25 do t'i trajtoj sipas radhës. Nëse ndonjë prej palëve dëshiron

1 të diskutojë ndonjë aspekt tjetër që nuk është shprehur në  
2 rendin e ditës së paraqitjes paraprake, jeni të ftuar ta bëni  
3 këtë me shkrim, duke më dorëzuar mua një parashtrim të  
4 protokolluar.

5 Z. Shala, pikësëpari do ju kërkoj të më konfirmoni nëse e  
6 keni marrë Aktakuzën e Konfirmuar në një gjuhë që ju e kuptoni  
7 dhe e flisni.

8 I AKUZUARI: Po, z. Gjyqtar, e kam marrë.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Shala.

10 I lutem Sekretares së Gjykatës tani të lexojë akuzat në  
11 aktakuzën e konfirmuar siç parashikohet në nenin 39 të Ligjin  
12 dhe rregullën 92.

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit.

14 1. Në Aktakuzën e Konfirmuar, Prokurorja e Specializuar  
15 akuzon z. Haxhi Shala për:

16 Pika 1: Tentim për pengimin e personave zyrtarë në  
17 kryerjen e detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë, e  
18 ndëshkueshme në bazë të nenit 401(1) dhe (5) të Kodit Penal të  
19 Kosovës të vitit 2019 dhe nenit 15(2) të Ligjit;

20 Pika 2: Tentim për pengimin e personave zyrtarë në  
21 kryerjen e detyrave zyrtare përmes pjesëmarrjes në veprimin e  
22 përbashkët të një grupi, e ndëshkueshme në bazë të nenit  
23 401(2) dhe (5) të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, dhe  
24 neni 15(2) të Ligjit;

25 Dhe Pika 3: Frikësim gjatë procedurës penale, e

1 ndëshkueshme në bazë të nenit 387 të Kodit Penal të Kosovës të  
2 vitit 2019 dhe nenit 15(2) të Ligjit.

3 2. Këto vepra penale u kryen midis së paku 5 dhe 12  
4 prillit 2023.

5 3. Në lidhje me këto vepra penale ekziston dyshimi i  
6 bazuar mirë se z. Haxhi Shala është penalisht përgjegjës në  
7 bazë të nenit 16(3) të Ligjit, për:

8 a. Kryerjen e veprës penale në pikën 3, në bazë të  
9 nenit 17 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019;

10 b. Bashkëkryerje me z. Ismet Bahtijari dhe z. Sabit  
11 Januzi të veprave penale në pikat 1 dhe 3, në bazë të nenit 31  
12 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019;

13 c. Ndhimë në kryerjen e veprave penale në pikat 1 dhe  
14 3, në bazë të nenit 33 të Kodit Penal të Kosovës të vitit  
15 2019;

16 d. Marrëveshje për të kryer së bashku me z. Ismet  
17 Bahtijari dhe z. Sabit Januzi veprat penale në pikat 1 dhe 3,  
18 në bazë të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019; dhe/ose

19 e. Tentim për kryerjen e veprave penale në pikat 1 dhe  
20 2, në bazë të nenit 28 të Kodit Penal të Kosovës të vitit  
21 2019.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Sekretare.

23 Z. Shala, dëshiroj t'ju kujtoj se nuk është sot momenti  
24 për të kontestuar akuzat, por thjeshtë të pranoni se i kuptoni  
25 akuzat. Do të keni plot mundësi që t'i kundërshtoni akuzat me

1 ndihmën e avokatit tuaj.

2 Z. Shala, a i kuptuat akuzat që gjenden në Aktakuzën e  
3 Konfirmuar që ua lexoi Sekretarja e Gjykatës?

4 I AKUZUARI: Po, z. Gjyqtar.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Shala.

6 Tani dëshiroj t'ju informoj për të drejtat që keni ju  
7 përpara kësaj Gjykate.

8 Ligji për Dhomat e Specializuar dhe Rregulloret e  
9 Procedurës dhe Provave ju garantojnë një sërë të drejtash. Do  
10 u lexoj të drejtat më të rëndësishme.

11 Së pari, ju prezumoheni i pafajshëm derisa të vërtetohet  
12 fajësia juaj përtej dyshimit të arsyeshëm.

13 Në procesin e vërtetimit të akuzave kundër jush, keni të  
14 drejtën për seancë të drejtë dhe publike, në vartësi të masave  
15 që urdhërohen për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve.

16 Keni të drejtën të informoheni sa më shpejt dhe me  
17 hollësi në një gjuhë që ju e kuptoni mbi natyrën dhe shkaqet e  
18 akuzave kundër jush.

19 Keni të drejtën për të pasur kohë dhe instrumente të  
20 mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes suaj, si dhe të  
21 komunikoni me mbrojtjen tuaj me një mbrojtës që ju e zgjidhni  
22 vetë.

23 Ju keni të drejtën të gjykoheni brenda një afati të  
24 arsyeshëm.

25 Keni të drejtën të gjykoheni në praninë tuaj fizike dhe



1 të mbroni veten përmes mbrojtësit tuaj.

2 Keni të drejtën t'ju caktohet një mbrojtës pa pagesë nëse  
3 nuk keni mjete të mjaftueshme financiare që ta paguani.

4 Keni të drejtën të pyesni ose t'ju pyesin për dëshmitarët  
5 kundër jush dhe do të merrni informacionin dhe të pyeten  
6 dëshmitarët për llogarinë tuaj.

7 Keni të drejtën për një përkthyes falas nëse nuk kuptoni  
8 ose flisni gjuhën që përdoret në Gjykatë.

9 Keni të drejtën të mos detyroheni të dëshmoni kundër  
10 vetes tuaj ose të pranoni fajësinë.

11 Keni të drejtën të heshtni dhe asnjë pasojë negative nuk  
12 do të ketë nga kjo heshtje.

13 Ju keni të drejtën të bëni deklaratë por jo nën betim në  
14 lidhje me çështjen gjyqësore dhe ju mund të paraqiteni si  
15 dëshmitar nën betim.

16 Ju keni të drejtën të dorëzoni mocione paraprake për të  
17 kundërshtuar juridiksionin e Dhomave të Specializuara, të  
18 pretendoni mangësi në formën e aktakuzës dhe të kërkoni  
19 veçimin e akuzave në aktakuzë.

20 Ju keni të drejtën që brenda 30 ditësh nga seanca e sotme  
21 të merrni materialet mbështetëse lidhur me aktakuzën që është  
22 dorëzuar për konfirmim.

23 Ju keni të drejtën të merrni të gjitha deklaratat të  
24 dëshmitarëve që synon Prokuroria e Specializuar në thërrasë në  
25 Gjykatë, në një gjuhë që ju e kuptoni dhe e flisni,

1 gjegjësisht, gjuha shqipe.

2 Keni të drejtën të merrni menjëherë çdo informacion që  
3 mund të përmbajë në mënyrë të arsyeshme informacione për  
4 pafajësinë tuaj apo të zbusë fajësinë tuaj apo që ndikon në  
5 besueshmërinë edhe mbështetshmërinë e provave të Prokurorit të  
6 Specializuar sapo që ky informacion të jetë kujdestarinë,  
7 kontrollin apo në dijeni e Prokurorisë.

8 Ju keni të drejtën që të gjitha materialet dhe provat  
9 përkatëse apo faktet që Prokurori i Specializuar ka në zotërim  
10 t'ju vendosen në dispozicion përpara dhe gjatë procesit  
11 gjyqësor. Kjo e drejtë do të jetë objekt vetëm për kufizimet  
12 që janë domosdoshmërisht të rrepta dhe sa herë që është e  
13 nevojshme që të zbatohen masa kompensuese.

14 Keni të drejtën të mos mbaheni i ndaluar për një periudhë  
15 kohore të paarsyeshme përpara çeljes së gjykimit tuaj, të  
16 kërkonit rishikimin e ndalimit tuaj, paraburgimit tuaj, edhe të  
17 apeloni çdo vendim përpara Gjykatës së Apelit.

18 Keni të drejtën të dorëzoni apel përpara Gjykatës së  
19 Apelit një vendim mbi mocionet paraprahe ku kundërshtohet  
20 juridiksioni i Dhomave të Specializuara.

21 Keni të drejtën të kërkonit leje për të apeluar dhe  
22 vendime të tjera.

23 Z. Shala, dëgjuat të drejtat më të rëndësishme që ju  
24 gëzoni në përputhje me kornizën ligjore në fuqi të Dhomave të  
25 Specializuara. A i kuptuat këto të drejta z. Shala?

1 I AKUZUARI: Po, i nderuar.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Shala.

3 Dëshiroj t'ju informoj se në përputhje me nenin 21(5) të  
4 Ligjit, ju nuk mund të përfaqësoni veten tuaj sepse aktualisht  
5 jeni në paraburgim. Përfaqësimi përmes Mbrojtësit të  
6 Specializuar është rrjedhimisht i detyrueshëm. Është detyra  
7 ime si Gjykatës i Procedurës Paraprake të garantohem që e  
8 drejta juaj për mbrojtje të respektohet.

9 Për këtë qëllim, marr parasysh parashtrimin e  
10 protokolluar të Zyrës Administrative ku më informojnë për  
11 caktimin e avokatit kujdestar.

12 Me sa kuptova nga parashtrimi i Zyrës Administrative në  
13 kohën që presim emërimin e avokatit tuaj përfundimtar ju është  
14 caktuar si avokat kujdestar z. Laurens van Puyenbroeck në  
15 përputhje me pjesën 17(2) të Direktivës për Mbrojtje dhe  
16 rregullës 21 për Ndihmën Ligjore.

17 Z. Shala, a mund të na konfirmoni se ju është caktuar z.  
18 Laurens van Puyenbroeck si avokat kujdestar?

19 I AKUZUARI: Po, i nderuar, deri të vendoset vendimi  
20 tjetër kënd do ta kem mbrojtës, do të jetë ky avokati im.  
21 Faleminderit.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Shala.

23 I akuzuari pra, përfaqësohet aktualisht nga një mbrojtje.

24 Tani i drejtohem mundësisë së të akuzuarit për t'u  
25 vetëdeklaruar i pafajshëm ose i pafajshëm në përputhje me

1 rregullën 92.

2 Z. Shala, brenda 30 ditësh nga dita e sotme, do t'ju  
3 thërrasin për të pranuar fajësinë apo për t'u vetëdeklaruar i  
4 pafajshëm për secilën nga akuzat në Aktakuzën e Konfirmuar.  
5 Nëse dëshironi ju mund ta bëni edhe sot, mund të pranoni  
6 fajësinë ose të vetëdeklaroheni i pafajshëm.

7 Rrjedhimisht, dëshiroj t'ju pyes z. Shala, nëse keni  
8 pasur mundësi të diskutoni akuzat në Aktakuzën e Konfirmuar me  
9 avokatin tuaj dhe nëse jeni i përgatitur aktualisht të bëni  
10 deklarimin tuaj. Nëse doni të vetëdeklaroheni tani, ju kërkoj  
11 të çoheni në këmbë dhe të bëni vetëdeklarimin tuaj, z. Shala.

12 I AKUZUARI: Derisa t'i marr të gjitha materialet nga  
13 Prokuroria, nuk mund të deklarohej. Sot po e lemë për seancën  
14 tjetër. Faleminderit.

15 GJYKATËSI GUILLLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Shala.

16 Duke patur parasysh se z. Shala nuk është vetëdekluar në  
17 këtë kohë do t'u kërkoja palëve që t'i paraqisnin mendimet e  
18 tyre paraprake lidhur me caktimin e një seance të ardhshme për  
19 vetëdeklarim, duke filluar me Mbrojtjen dhe pastaj me Zyrën e  
20 Prokurorisë.

21 Z. Avokat Mbrojtës, ju pra e keni fjalën për caktimin e  
22 datës.

23 Z. VAN PUYENBROECK: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, unë  
24 nuk kam parashtime për të bërë lidhur me çështje.

25 Faleminderit.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

2 Znj. Prokurore.

3 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës,  
4 faleminderit. Edhe unë nuk kam parashtrim për të bërë lidhur  
5 me caktimin e datës.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

7 Do të caktohet atëherë në kohën e duhur një seancë e re  
8 për të -- për vetëdeklarimin.

9 Tani të kalojmë tek gjuha. Unë në vendimin e kësaj seance  
10 i kërkoja palëve që të bëjnë parashtrime gojore lidhur me  
11 gjuhën e punës në këtë çështje gjyqësore sipas rregullës 8.

12 Palët a mund të tregojnë preferencën që kanë, dhe po e  
13 fillojmë me Zyrën e Prokurorisë.

14 Znj. Prokurore.

15 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Zyra e Prokurorit të  
16 Specializuar preferon gjuhën angleze, i nderuar Gjykatë.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.  
18 Prokurore.

19 Avokati Mbrojtës.

20 Z. VAN PUYENBROECK: [Përkthim] Pala mbrojtëse nuk sheh  
21 arsye për ta ndryshuar gjuhën e punës.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

23 Avokat Mbrojtës do ta nxjerr mendimin -- do ta nxjerr  
24 vendimin në kohën e duhur.

25 Në bazë të rregullës 96, do të caktoj seancën e parë të

1 Konferencës mbi Ecurinë e Çështjes ditën e premte, 15 dhjetor  
2 2023, në orën 09.30.

3 Synimi i kësaj Konference mbi Ecurinë e Çështjes do të  
4 jetë për të rishikuar statusin e kësaj çështje gjyqësore dhe  
5 për të bërë të mundur që palët të shkëmbejnë materialet me  
6 qëllim që të kemi përgatitjen e duhur dhe në kohë për  
7 gjykimin.

8 Z. Shala, dua t'ju përkujtoj se keni të drejtën që të  
9 merrni pjesë në këtë Konferencën mbi Ecurinë e Çështjes së  
10 bashku me avokatin tuaj. Megjithëkëtë me një miratim me shkrim  
11 dhe pas këshillës nga mbështetësi juaj dhe në bazë të  
12 rregullës 96(2) këtë Konferencë -- në këtë Konferencë mund të  
13 merrni pjesë ju personalisht dhe avokati me videolidhje; nga  
14 avokati juaj dhe z. Shala të marrë pjesë me videolidhje; dhe  
15 kjo mund të zhvillohet edhe në mungesën tuaj; dhe në praninë  
16 me videolidhje të Mbrojtësit tuaj.

17 I rikujtoj të gjithëve që në qoftë se Mbrojtësi apo i  
18 akuzuari dëshirojnë që të marrin pjesë me videolidhje duhet të  
19 dorëzojnë njoftim me shkrim 24 orë përpara seancës përkatëse  
20 dhe t'i dërgohet Zyrës Administrative me qëllim që të mund të  
21 bëhen përgatitjet e duhura logjistike. Njoftimi i tillë do të  
22 duhet të dërgohet me email tek Zyra Administrative dhe duhet  
23 të përfshijë edhe miratimin me shkrim nga e të akuzuarit. Zyra  
24 Administrative do t'i protokollojë këto emaile si  
25 korrespondenca në materialet dhe procesverbalin e kësaj

1 procedure.

2 Tani do t'i kërkoj palës Mbrojtëse nëse parashikon të  
3 marrë pjesë në Konferencën mbi Ecurinë e Çështjes me  
4 videolidhje.

5 Z. VAN PUYENBROECK: [Përkthim] Jo, ne do të paraqitemi  
6 personalisht.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Avokat  
8 Mbrojtës. Gjatë pasdites do t'ju jepet edhe data e kësaj  
9 konference.

10 Do t'i kërkoj po kështu palëve që të paraqesin  
11 parashtrime me shkrim lidhur me tematikën e kësaj Konference  
12 mbi Ecurinë e Çështje dhe mbi çështje të tjera që duan të  
13 ngrenë në këtë Konferencë të ditës së premtë. Unë synoj që e  
14 enjtja, data 14 dhjetor, ora 4, do të jetë data për paraqitjen  
15 e këtyre parashtrime me shkrim.

16 Pas Konferencës mbi Ecurinë e Çështjes, unë do të lëshoj  
17 vendimin lidhur me detyrimet që ka Zyra e Prokurorit të  
18 Specializuar për nxjerrjen e materialeve në pajtim me  
19 rregullën 102, si dhe mbi modelin e redaktimeve për këtë  
20 procedurë. Dhe unë ju rekomandoj palëve që të konsultojnë  
21 vendimet e mëparshme që kam nxjerrë në çështjet gjyqësore të  
22 mëparshme. Megjithëkëtë, unë do të kërkoj parashtrime nga  
23 palët përpara se ta nxjerr këtë vendim.

24 Në këtë pikë, dua t'ju kërkoj palëve nëse kanë ndonjë  
25 çështje tjetër që dëshirojnë të ngrenë. Dhe e fillojmë me

1 Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

2 Znj. Prokurore, ju e keni fjalën.

3 ZNJ. SHAHABUDDIN: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës, nuk  
4 kemi çështje të tjera për të ngritur ditën e sotme.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.  
6 Prokurore.

7 Tani pala Mbrojtëse.

8 Z. VAN PUYENBROECK: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nuk  
9 kemi çështje tjetër për të ngritur.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, avokat.

11 Tani do t'i kërkoj të akuzuarit përpara se ta përfundojmë  
12 këtë seancë.

13 Pra, z. Shala, a keni ndonjë çështje që dëshironi të  
14 ngrini lidhur me arrestimin tuaj, transferimin në Hagë apo  
15 kushtet e paraburgimit.

16 Z. Shala.

17 I AKUZUARI: Jo, nuk kemi. Gjithçka është në rregull.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Shala.

19 Z. Shala duke qenë që mbeteni në paraburgim, dua t'ju  
20 informoj se keni të drejtën që ta kundërshtoni mbajtjen në  
21 paraburgim në pajtim me rregullën 57. Dhe kjo çështje do të  
22 trajtohet me anë vendimeve me shkrim.

23 Këtu përfundon edhe seanca e ditës së sotme. Si zakonisht  
24 i falënderoj palët dhe pjesëmarrësit për pjesëmarrjen e tyre.  
25 Falënderoj po kështu edhe përkthyesit, stenografët, teknikët



1 audio-vizual, personin e sigurisë për ndihmën që kanë dhënë.

2 Seanca këtu përfundon.

3 --- Seanca mbyllet në orën 14.26

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25